
Kapërcimi i ndarjes gjuhësore

Nga dygjuhësia formale te kapaciteti funksional gjuhësor në Kosovë



NEW
SOCIAL
INITIATIVE

Kapërcimi i ndarjes gjuhësore

Nga dygjuhësia formale te kapaciteti funksional gjuhësor në Kosovë

BOTUES:

New Social Initiative - NSI
www.newsocialinitiative.org

AUTOR:

Miodrag Denić

Tetor 2026, Mitrovicë e Veriut

Ky publikim është përgatitur nga New Social Initiative me mbështetjen e Fondacionit Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy – NED). Pikëpamjet e shprehura janë vetëm të NSI-së dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të NED-it.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive 04

1. Hyrje 05

2. Përcaktimi dhe analiza e problemit 06

2.1. Hendeku institucional në zbatim 06

2.2. Arsimi si burim strukturor i problemit 06

2.3. Mekanizma ekzistues, por të pamjaftueshëm 07

2.4. Një dritare për politika: ringjallja e Gjuhës së mjedisit shoqëror 07

3. Rekomandime dhe përfundim 08

Referencat 10

Përmbledhje ekzekutive

Kosova ka një nga kornizat ligjore më të gjera për barazinë gjuhësore në Ballkanin Perëndimor. Neni 5 i Kushtetutës përcakton shqipen dhe serbishten si gjuhë zyrtare, ndërsa Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve garanton statusin e tyre të barabartë në institucionet e Kosovës. Megjithatë, hendeku ndërmjet dygjuhësisë formale dhe zbatimit të saj praktik mbetet i konsiderueshëm. Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2025 konstaton se përmbushja nga institucionet e detyrimeve që burojnë nga Ligji për Përdorimin e Gjuhëve mbetet e pamjaftueshme dhe se numri i përkthyesve dhe i interpretëve të kualifikuar në institucionet qendrore dhe komunale është i pamjaftueshëm.

Problemi nuk qëndron kryesisht te mungesa e të drejtave gjuhësore në ligj. Ai qëndron te rënia e kapacitetit institucional për t'i ushtruar këto të drejta në praktikë. Institucionet publike të Kosovës tradicionalisht janë mbështetur shumë te një brez më i vjetër punonjësish dygjuhësh. Ndërsa ky brez po largohet gradualisht nga tregu i punës, ai po zëvendësohet nga qytetarë më të rinj, të cilët në masë të madhe janë arsimuar në sisteme të ndara gjuhësisht dhe të cilët shpesh kanë pak ose aspak njohuri funksionale të gjuhës tjetër zyrtare.

Për rrjedhojë, arsimi ndodhet në qendër të problemit. Shqipja dhe serbishtja nuk u mësohen në mënyrë sistematike nxënësve që i përkasin komunitetit tjetër gjuhësor. OSBE-ja ka identifikuar vazhdimisht ndërveprimin e kufizuar ndërmjet sistemeve të kurrikulës së Kosovës dhe të kurrikulës së Serbisë, ndërsa Këshilli i Evropës ka vënë në dukje në mënyrë të ngjashme mungesën e vazhdueshme të mësimit reciprok të gjuhëve. Kjo krijon një kontradiktë strukturore: shteti kërkon shërbime publike dygjuhëshe, ndërsa sistemi arsimor nuk nxjerr në mënyrë sistematike qytetarë me aftësitë gjuhësore të nevojshme për t'i ofruar ato.


Prandaj, ky dokument politikash trajton pyetjen e mëposhtme të politikave:

Si mund ta shndërrojë Kosova dygjuhësinë formale në kapacitet funksional dhe të qëndrueshëm gjuhësor në arsim dhe në administratën publike?

Dokumenti propozon një qasje të koordinuar të mbështetur në tri shtylla që përforcojnë njëra-tjetrën: futjen e mësimit praktik të gjuhës tjetër zyrtare gjatë arsimit fillor dhe të mesëm; forcimin e rrugëve të arsimit të lartë për profesionistë dygjuhësh, veçanërisht të programit të Ballkanistikës në Universitetin e Prishtinës; dhe krijimin e stimujve dhe të trajnimeve të strukturuara gjuhësore brenda administratës publike.

Në vend që të synojë integrimin institucional të sistemeve arsimore që aktualisht janë të ndara, propozimi përqendrohet në një objektiv më të ngushtë dhe potencialisht më të realizueshëm: sigurimin që nxënësit të fitojnë aftësi praktike komunikimi në gjuhën tjetër zyrtare. Një version i përditësuar i konceptit të dikurshëm jugosllav të "Gjuhës së mjedisit shoqëror" (serbisht: Jezik društvene sredine) mund të shërbejë si pikënisje konceptuale, i përshtatur me standardet bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhëve dhe me kornizën aktuale institucionale të Kosovës.

Objektivi nuk është asimilimi gjuhësor, por shumëgjuhësia funksionale: t'u mundësohet qytetarëve qasja në institucionet publike, në punësim dhe në komunikimin e përditshëm, pa e dobësuar të drejtën e asnjë komuniteti për arsim në gjuhën e vet.



1.

Hyrje

Të drejtat gjuhësore zënë një vend qendror në arkitekturën kushtetuese dhe institucionale të Kosovës. Shqipja dhe serbishtja gëzojnë status të barabartë zyrtar, ndërsa turqishtja, boshnjakishtja dhe romishtja mund të marrin status zyrtar ose status të gjuhës në përdorim zyrtar në nivel komunal, sipas kushteve të përcaktuara me ligj. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve u kërkon gjithashtu institucioneve të Kosovës të sigurojnë përdorimin e barabartë të dy gjuhëve zyrtare.

Megjithatë, korniza ligjore është zhvilluar shumë më shpejt sesa kapaciteti shoqëror dhe administrativ i nevojshëm për zbatimin e saj.

Komisioni Evropian ka identifikuar vazhdimisht mangësi në zbatimin praktik të të drejtave gjuhësore. Raporti i tij i vitit 2025 vë në dukje përmbushjen e pamjaftueshme të ligjit për gjuhët nga institucionet, numrin e pamjaftueshëm të përkthyesve dhe të interpretëve të kualifikuar, si dhe vështirësitë me të cilat përballen institucionet publike, përfshirë gjykatat, në ofrimin e shërbimeve dhe të dokumenteve në të dyja gjuhët zyrtare. I njëjti raport vë në dukje gjithashtu se përfaqësimi i komuniteteve joshumicë në institucionet publike mbetet i pamjaftueshëm.

Këto probleme shpesh trajtohen kryesisht si çështje përkthimi, përputhshmërie administrative ose të drejtash të pakicave. Megjithatë, ato kanë edhe një dimension të rëndësishëm të politikave arsimore. Institucionet publike nuk mund të funksionojnë në mënyrë të qëndrueshme në dy gjuhë zyrtare nëse brezat e njëpasnjëshëm hyjnë në tregun e punës pa pasur mundësi të fitojnë qoftë edhe njohuri bazë të gjuhës tjetër zyrtare.

Ndarja e rrugëve arsimore e thellon këtë problem. Hulumtimet dhe monitorimet e kryera nga organizatat ndërkombëtare kanë vënë në dukje vazhdimisht kontaktin e kufizuar ndërmjet nxënësve të arsimuar sipas kurrikulës së Kosovës dhe asaj të Serbisë, si dhe mungesën e mundësive sistematike për mësimin reciprok të gjuhëve. OSBE-ja ka argumentuar se kjo ndarje i zvogëlon mundësitë për ndërveprim ndërkomunitar dhe e kufizon integrimin arsimor dhe në punësim.

Prandaj, çështja duhet kuptuar jo thjesht si çështje e mbrojtjes së të drejtave gjuhësore, por edhe si çështje e kapacitetit shtetëror. Dygjuhësia funksionale ndikon në qasjen në shërbimet publike, në rekrutimin në administratën publike, në cilësinë e përkthimit dhe të interpretimit, në komunikimin ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve, si dhe në kapacitetin e shtetit për të zbatuar kornizën e vet ligjore.

Rrjedhimisht, ky dokument e zhvendos vëmendjen nga dygjuhësia formale te dygjuhësia funksionale: nga pyetja nëse dy gjuhë njihen ligjërisht, te pyetja nëse institucionet dhe qytetarët kanë kapacitetin praktik për t'i përdorur ato.

2.

Përcaktimi dhe analiza e problemit

Problemi qendror i politikave është mospërputhja në rritje ndërmjet kornizës institucionale dygjuhëshe të Kosovës dhe aftësive gjuhësore që prodhon sistemi i saj arsimor.

2.1. Hendeku institucional në zbatim

Kushtetuta dhe legjislacioni për gjuhët nisen nga supozimi se institucionet publike mund të funksionojnë si në shqip, ashtu edhe në serbisht. Megjithatë, rrugët arsimore përmes të cilave formohen nëpunësit civilë, mësimdhënësit, juristët, përkthyesit, profesionistët shëndetësorë dhe punonjësit e tjerë publikë të së ardhmes mbeten kryesisht njëgjuhëshe.

Kjo kontradiktë bëhet gjithnjë e më e rëndësishme me ndërrimin e brezave brenda administratës publike. Punonjësit më të vjetër, të cilët i përvetësuan njohuritë e shqipes dhe të serbishtes në një mjedis tjetër arsimor dhe shoqëror, po largohen gradualisht nga fuqia punëtore. Brezat më të rinj janë rritur në mjedise shumë më të ndara gjuhësisht. Prandaj, pa ndërhyrje përmes politikave, mund të pritet që kapaciteti administrativ dygjuhësh të varet gjithnjë e më shumë nga përkthimi profesional në vend të komunikimit të drejtpërdrejtë.

Përkthimi mbetet i domosdoshëm në një administratë dygjuhëshe, veçanërisht për legjislacionin dhe dokumentacionin zyrtar. Megjithatë, ai nuk duhet të bëhet zëvendësues i kompetencës bazë gjuhësore të punonjësve publikë. Varësia e tepruar nga përkthimi i rrit kostot administrative, e ngadalëson komunikimin dhe e bën zbatimin e të drejtave gjuhësore të varur nga një numër i kufizuar profesionistësh të specializuar. Konstatimi i Komisionit Evropian se institucionet vazhdojnë të përballen me mungesë përkthyesish të kualifikuar e dëshmon cenueshmërinë e një modeli të tillë.

2.2. Arsimi si burim strukturor i problemit

Rrënjët e këtij problemi gjenden pjesërisht në strukturën e arsimit.

Nxënësit nga komunitetet boshnjake dhe turke që ndjekin kurrikulën e Kosovës kanë pasur mundësi ta mësojnë shqipen, ndërsa mësimi reciprok i shqipes dhe i serbishtes mbetet veçanërisht i dobët. Këshilli i Evropës ka vënë në dukje se serbishtja nuk mësohet në shkollat që zbatojnë kurrikulën e Kosovës dhe se shqipja në përgjithësi nuk mësohet në shkollat që zbatojnë kurrikulën e Serbisë. Vlerësimet e mëhershme të OSBE-së kishin arritur në përfundim të ngjashëm, se ndarja fizike dhe kurrikulare e dy sistemeve e kufizon ndjeshëm ndërveprimin ndërmjet nxënësve shqipfolës dhe serbishtfolës.

Kjo sjell pasoja që shkojnë përtej vetë arsimit. Një i ri serb i Kosovës që nuk flet shqip përballet me mundësi më të ngushta punësimi dhe ndërveprimi në mjediset kryesisht shqipfolëse. Njëkohësisht, një nëpunës publik shqipfolës pa kompetenca në gjuhën serbe është më i varur nga përkthimi kur komunikon me qytetarët serbishtfolës. Prandaj, kostot e njëgjuhësisë i bartin si qytetarët, ashtu edhe institucionet.

2.3. Mekanizma ekzistues, por të pamjaftueshëm

Disa themele institucionale për kapërcimin e kësaj ndarjeje ekzistojnë tashmë.

Programi i Ballkanistikës në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës është hartuar posaçërisht për të forcuar komunikimin ndërgjuhësor dhe ndërkulturor dhe për të formuar profesionistë të aftë për përkthim ndërmjet gjuhëve zyrtare të Kosovës dhe gjuhëve të tjera ballkanike. Kurrikula e tij përfshin përkthimin, praktikën gjuhësore dhe praktikat profesionale në institucionet publike. Programi aktualisht është i akreditуar deri në vitin 2029.

Megjithatë, arsimi i lartë vetëm nuk mund ta kompensojë mungesën e kontaktit të hershëm me gjuhën. Komisioni Evropian kishte vënë në dukje që në raportin e vitit 2023 se programi historikisht kishte pasur regjistrim shumë të ulët, pavarësisht se ishte i vetmi program brenda sistemit arsimor të Kosovës që ofrohej në të dyja gjuhët zyrtare. Prandaj, krijimi i një oferte të qëndrueshme profesionistësh dygjuhësh kërkon si mësimin më të hershëm të gjuhës, ashtu edhe stimuj më të qartë punësimi për studentët që vendosin të zhvillojnë aftësi të avancuara dygjuhëshe.

Nismat e shoqërisë civile, përfshirë projektet që nxitin mësimin e gjuhëve dhe kontaktin ndërkomunitar, mund ta plotësojnë këtë proces. Nisma të tilla si ato që organizohen përmes Europe House (Shtëpia e Evropës) dhe organizatave të tjera krijojnë mundësi të vlefshme për ndërveprim vullnetar. Megjithatë, karakteri i tyre i bazuar në projekte dhe vullnetar nënkupton se ato nuk mund ta zëvendësojnë arsimin sistematik gjuhësor që arrin te brezat e njëpasnjëshëm të nxënësve.

2.4. Një dritare për politika: ringjallja e Gjuhës së mjedisit shoqëror

Një pikënisje e dobishme konceptuale ekziston tashmë në historinë arsimore të vetë rajonit. Gjatë periudhës jugosllave, zonat shumëgjuhëshe përdornin variante të modelit të “Gjuhës së mjedisit shoqëror”, sipas të cilit nxënësit mësonin një gjuhë tjetër me rëndësi në nivel lokal. Hulumtimet për këtë model tregojnë se parimi i tij themelor nuk ishte zëvendësimi i gjuhës amtare, por trajtimi i shumëgjuhësisë si burim shoqëror.

Rifutja e kësaj ideje sot nuk duhet të nënkuptojë rikthimin e modelit të dikurshëm pa ndryshime. Një program bashkëkohor do të duhej të ishte vullnetar ose të zbatohej me faza, aty ku është e përshtatshme, pedagogjikisht modern, i përqendruar kryesisht në komunikimin e përditshëm dhe i hartuar në konsultim me komunitetet përkatëse. Korniza e Përbashkët Evropiane e Referencës për Gjuhët (KPERGJ) mund të ofronte rezultate të matshme të të nxënit dhe t’u mundësonte nxënësve të përparonin gradualisht drejt niveleve të njohura të aftësisë A1–B2.

Prandaj, sfida e politikave nuk është krijimi i një sistemi krejtësisht të ri dygjuhësh. Ajo është lidhja e institucioneve që ekzistojnë tashmë — shkollave, universiteteve dhe administratës publike — në një rrugë koherente, përmes së cilës dygjuhësia funksionale bëhet praktikisht e dobishme dhe e shpërblyer profesionalisht.

3.

Rekomandime dhe përfundim

Masat e politikave të zhvilluara në këtë dokument janë konceptuar si një paketë që përforcohet reciprokisht, e jo si ndërhyrje të veçuara.

1. **Futja e një programi të përditësuar të "Gjuhës së mjedisit shoqëror" në arsimin fillor dhe të mesëm.** MASHTI mund të hartojë një kurrikulë praktike, të orientuar drejt komunikimit, që u mundëson nxënësve shqipfolës të mësojnë serbisht dhe nxënësve serbishtfolës të mësojnë shqip. Në vend që të fillojë menjëherë me zbatim në mbarë vendin, programi fillimisht mund të pilotohet në komuna dhe shkolla të përzgjedhura shumëgjuhëshe. Theksi i tij duhet të vihet te komunikimi i përditshëm, e jo te mësimdhënia e mbingarkuar me letërsi ose e dominuar nga gramatika. Rezultatet e të nxënit duhet të përputhen me standardet e KPERGJ-së dhe të vlerësohen pas një faze fillestare pilotuese.

2. **Krijimi i një rruge më të fortë nga arsimi te punësimi përmes programit të Ballkanistikës.** Programi ekzistues në Universitetin e Prishtinës ofron një bazë institucionale për formimin e përkthyesve, të mësimdhënësve të gjuhëve dhe të profesionistëve dygjuhësh. Bursat publike, mbështetja për akomodimin e studentëve, praktikat e paguara dhe vendosjet e strukturuara në institucionet publike mund ta rritin vlerën praktike të programit. Bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe institucioneve që përballen me mungesë stafi serbishtfolës dhe shqipfolës mund të krijojë një kalim më të drejtpërdrejtë nga diplomimi te punësimi.

3. **Zhvillimi i trajnimit sistematik në gjuhën e dytë zyrtare brenda administratës publike.** Nëpunësit civilë të sapo rekrutuar që punojnë në pozita që përfshijnë kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët duhet të kenë qasje në kurse të strukturuara gjuhësore. Kompetenca dygjuhëshe në nivelin B1 ose B2 mund të njihet përmes stimujve në rekrutim, krediteve për zhvillim profesional ose kritereve për ngritje në detyrë, aty ku kjo është relevante për pozitën. Kjo do ta zhvendoste gradualisht dygjuhësinë nga trajtimi i saj kryesisht si shërbim përkthimi drejt shndërrimit të saj në aftësi administrative.

4. **Vendosja e monitorimit të përbashkët të kapacitetit gjuhësor.** MASHTI, Zyra e Kryeministrit, institucionet përkatëse të administratës publike dhe Zyra e Komisionerit për Gjuhët duhet të vlerësojnë periodikisht disponueshmërinë e personelit dygjuhësh, kapacitetin përkthyes dhe kërkesën për aftësi gjuhësore në institucionet publike. Një monitorim i tillë do të mundësonte që bursat, trajnimet dhe stimujt për rekrutim të shënjestroheshin drejt fushave ku mungesat janë më të theksuara.

Këto masa nuk do t'i eliminonin ndarjet politike, historike ose institucionale që lidhen me politikat arsimore dhe gjuhësore. As mësimi i gjuhëve nuk duhet paraqitur si zëvendësues i dialogut më të gjerë ndërkomunitar. Qëllimi i tyre është më i ngushtë dhe më praktik: të parandalohet që ndarja gjuhësore ta minojë gradualisht zbatimin e të drejtave që tashmë ekzistojnë në ligj.

Prandaj, Kosova nuk ka nevojë kryesisht për deklarata shtesë mbi dygjuhësinë. Ajo ka nevojë për kapacitetin njerëzor për ta zbatuar dygjuhësinë.

Një program i përditësuar i Gjuhës së mjedisit shoqëror, i lidhur me formimin profesional në nivel universitar dhe me stimuj brenda administratës publike, do të ofronte një rrugë nga shkolla te punësimi dhe nga barazia ligjore e gjuhëve te qasja praktike në institucione.

Objektivi afatgjatë nuk është që çdo qytetar të bëhet përsosmërisht dygjuhësh. Ai është që njohja e një gjuhe tjetër zyrtare të bëhet sërish një aftësi e arritshme, e dobishme dhe e vlerësuar institucionalisht. Në këtë kuptim, politika gjuhësore mund t'u shërbejë njëkohësisht dy qëllimeve: mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve të ndryshme gjuhësore dhe përmirësimit të funksionimit të përditshëm të institucioneve publike.

Referencat

Assembly of Kosovo. (2007). Law No. 02/L-37 on the Use of Languages. Official Gazette.

Assembly of Kosovo. (2008). Constitution of the Republic of Kosovo, Article 5.

Assembly of Kosovo. (2023). Law No. 08/L-197 on Public Officials, as subsequently amended.

Council of Europe. (2020). Common European Framework of Reference for Languages: Learning, Teaching, Assessment – Companion Volume. Council of Europe Publishing.

European Commission. (2023). Kosovo 2023 Report.

European Commission. (2025). Kosovo 2025 Report. Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood.

Mandić, M., & Rácz, K. (2023). Learning the language of social environment: the case of Hungarian in Vojvodina (Serbia). Current Issues in Language Planning, 24(4), 460–480.

OSCE Mission in Kosovo. (2009). Kosovo Non-Majority Communities within the Primary and Secondary Educational Systems.

OSCE Mission in Kosovo. (2018). Communities' Access to Pre-University Education in Kosovo.

University of Prishtina. (2026). Balkanistics – Faculty of Philology: Study Programme and Curriculum.



NEW
SOCIAL
INITIATIVE